



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrri

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

### K R I T E R E T

*Për shpalljen e "Sportistit të vitit 2024"*

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Vushtrrisë në fund të çdo viti bënë shpalljen e më të mirëve si: Sportistin e vitit, Klubin Sportiv më të suksesshëm, Trajnerin më të mire, Referin më të mirë, Punëtorin Sportiv, Gazetarin Sportiv, Shpresat e vitit, ndarja e mirënjohjeve për mediat për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit.

Komisionit duhet ti paraqiten Propozimet nga Klubet Sportive me arsyetime për secilin propozim të bërë, deri me datë **20.01.2025**.

Komisioni për shpalljen e sportistëve më të mirë për vitin 2024 duhet të u përmbahen KRITEREVE të poshtëshënuara:

#### **1. Sportist i vitit mund të shpallët ai sportist i cili:**

- a) Ka paraqitje kulminante, cilësore dhe të ketë arritje të larta individuale apo me klub,
  - 1.Ndërkombëtare;
  - 2.Kombëtare;
  - 3.Nacionale, dhe
  - 4.Rajonale.
- b) Klubi i cili është paraqitur të ketë arritur suksese gjatë vitit kalendarik 2024, në garat ndërkombëtare apo vendore.
- c) Të ketë paraqitje standarde dhe numër të madh të paraqitjeve me klube, të jetë anëtar/e e reprezentacionit të shtetit.
- d) Të jetë i disiplinuar, i sjellshëm në kuadër të klubit ku është i/e inkuadruar.

**2. Klubi sportive i vitit mund të shpallet:**

- a) Klubi sportiv i cili në arenën ndërkombëtare ka arritur suksese;
- b) Klubi sportive i cili në arenën vendore ka arritje të larta;
- c) Rangu i garave ku klubi sportive garon;
- d) Masiviteti i garave, dhe
- e) Organizimi i Klubit.

**Vërejtje:** Nëse Komisioni për Shpalljen e Sportistit të vitit, vëren se në aplikacione ka informata të pa sakta dhe të fryra nga kushdo do të kërkohen sqarime shtesë, po ashtu nese ndonjë lojtar që ka arritje të mira dhe nuk është propozuar nga klubi, komisioni do të kërkojë nga klubi dhe institucionet tjera informata të tjera shtesë që të përfshijë në listë atë sportist/e.

Kriteret e lartshënuara për sportistin dhe klubet sportive vlejné edhe me rastin e shpalljes së më të mirëve edhe te “Shpresat e vitit”, “Punëtori sportiv i vitit”, “Trajneri i vitit”, “Pedagogu i vitit”, “Gazetari sportiv”.

Të gjitha materialet dorëzohen përmes arkivës komunale, në pliko të mbyllura, dhe nuk hapen deri në mbledhjen e komisionit.



Dr.sc.Izet Miftari

Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport